

1. Kryerja e krasitjes së gjelbër sipas provave tregoi se, në provën e tretë ku në çdo degë skeletore u hoq 10 % e masës së gjelbër bima pati një zhvillim më të mirë dhe cilësia e frutave ishte më e mirë.

2. Krasitja e gjelbër ndikon në cilësinë e prodhimit, bima ajroset më mirë duke ulur rrezikun e prekjës nga sëmundjet e dëmtuesit. (pesha e frutit ishte më e madhe në provën e tretë).

Konkluzione

Nëpërmjet këtij studimi u evidentua nevoja e kryerjes së operacioneve të gjelbra (krasitjes verore). Të dhënat e marra në disa vende të mbjellë me nektarinë tregoi se:

1. Në bimët ku u realizua krasitja verore ishin me zhvillim më të mirë dhe me prodhim më cilësorë.

2. Kryerja e krasitjes verore është një punë paraprake për krasitjen dimërore të vitit pasardhës, sepse ndihmon duke e lehtësuar punën e krasitësit.

3. Kryerja në kohë e me profesionalizëm e kësaj hallke të teknologjisë ndikon në rritjen e cilësisë së prodhimit e cila në kushtet e sotme është e rëndësishme.

Mesazhi për fermerin

Është i domosdoshëm zbatimi i të gjitha hallkave të teknologjisë së kultivimit të pjeshkës për të marrë një prodhim cilësorë.



**QENDRA E TRANSFERIMIT
TË TEKNOLOGJIVE
BUJQËSORE VLORË**

**Ndikimi i krasitjes verore në treguesit biologjik
dhe agronomik të prodhimit në pjeshkën
Nektarina.**



Kjo fletë palosje synon t'u vij në ndihmë të gjithë fermerëve që duan të kultivojnë kulturën e pjeshkës (nektarinë).

Pemëtaria në vendin tonë po zhvillohet me ritme të larta por, dalja në treg e një numri të madh të kultivareve të pemëve frutore në vendin tonë, është domoshmëri dhe njohja e teknologjive të reja për të patur një prodhim sasior e cilësor që të jetë konkurrues në treg.

Një nga teknikat e menaxhimit të ekuilibrit midis rritjes vegetative dhe prodhimit në pemëtore është dhe aplikimi i operacioneve të gjelbra. Duke qenë e lidhur me vegetacionin, në aplikimin e saj duhet njohur fiziologjia e zhvillimit të bimës. Ai përfshin ndërhyrjet e hershme në lastarët në rritje me largimin e tyre, rrallimin e frutave, ndërhyrje në faza më të avancuara të rritjes së lastarëve si rrallimin, përkuljen, pincimin, përdredhjen ose unazimin e tyre. Këto operacione ndikojnë në ngadalësimin e rritjes vegetative të lastarëve të fuqishëm duke provokuar daljen e sythave lulor. Ato frenojnë një shpenzim të energjisë në një drejtim të padobishëm, duke e drejtuar zhvillimin e bimës sipas formës së përcaktuar për shfrytëzimin sa më mirë të hapësirës dhe në balancimin e shpërndarjes së asimilateve.

Vendi: Rrethi; Vlorë (Fshati-Dukat)

Ngritja e studimit

Në fshatin Dukat në parcelën e mbjellë me pjeshkë (nektarinë) u vendos që studimi të bëhet në tre prova.

Prova e parë: pa ndërhyrje

Prova e dytë: duke eliminuar 10% të lastarëve në të gjithë bimën.

Prova e tretë: duke larguar 10% të lastarëve në çdo degë skeletore.



TË DHËNAT PEDOLOGJIKE DHE KIMIKE TË TOKËS

Hori-zonti	pH	Humusi		N		P	
		%	V	%	M	ppm	V
A2	7.1	1.4	V	0.118	M	2.7	V
A1	6.5	1.0	V	0.089	V	6.2	M
0-30	6.9	1.8	M	0.138	M	3.8	V


TREGUESIT E FUQISË SË BIMËS

Për matjen e vëllimit të kurorës të dhënat u morën pas krasitjes dhe kur bima sapo ka filluar aktivitetin e saj dhe matjet e dyta u morën në muajin Nëntor kur bima është futur në qetësinë dimërore dhe rritja vjetore ka përfunduar.

U kryen matjet për lartësinë e bimës në të dy muajt Mars dhe Dhjetor.

Për matjen e Vëllimit të kurorës u përdor formula:


$$VC = \frac{2}{3}\pi D^2/4.H$$




RRITJA E SIPËRFAQES SË TRUNGUT

Matjet për llogaritjen e sipërfaqes së trungut u kryen në dy periudhe në muajin Mars dhe muajin Nëntor. Llogaritja e sipërfaqes së rritjes së trungut u llogarit me formulën.

$$ST = 3.14(P/2\pi)^2$$



Pesha mesatare e frutit



Vlerësimi i rezultateve: Nëpërmjet këtij studimi dyvjeçar u evidentua nevoja e kryerjes së operacioneve të gjelbra, pasi kjo ndërhyrje është e rëndësishme sepse nëpërmjet saj realizohet një raport i mirë midis masës gjethore e asaj drunore.

